



**K O R N I Z A  
A F A T M E S M E  
B U X H E T O R E (KAB) e  
K O M U N Ë S S Ë V U S H T R R I S Ë  
2013-2015**

---

**Kuvendi i Komunës**

**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA**

**Korrik, 2012**

# Përmbajtja

## I. Hyrje

## II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

## III. Korniza Fiskale

### 3.1 Korniza makroekonomike komunale

### 3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2013-2015

### 3.3 Donatorët e jashtëm

### 3.4 Politikat e reja

### 3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2013-2015


## IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve

### **I. Hyrje**

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2013/2015 të pranuar nga Ministria e Financave.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2013-2015. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Vushtrrisë (ende sipas shënimeve jo zyrtare) ka mbi 70.145 banorë, 11.872 ekonomi familjare, me strukturë gjinore 35.123 meshkuj dhe 35022 femra, popullsi e re dhe e aftë për punë, gjithashtu me përgatitje të kënaqshme profesionale.



Komuna e Vushtrrisë gjeografikisht shtrihet në mes dy qendrave, Prishtinës dhe Mitrovicës që mundësojnë qasje të lehtë dhe të shpejt në këto tregje shumë të fuqishme. Komuna e Vushtrrisë ka një sipërfaqe prej 345km<sup>2</sup>, duke iu falënderuar kushteve dhe pasurive, në radhë të parë tokës shumë pjellore e cila ofron kushte shumë të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore lavërtare dhe kopshtare. Vushtrria është e njohur sidomos me prodhimin e patates së kualitetit të lartë.

Komuna e Vushtrrisë ka të regjistruara 3070 biznese prej të cilave një numër i konsiderueshëm janë prodhuese që merren me prodhim dhe punësojnë një numër të caktuar të punëtorëve, numri më i madh i bizneseve janë nga lëmia e tregtisë me shumicë dhe pakicë dhe përkundër disa objekteve të cilat kanë një numër të madh të punëtorëve. Pjesa tjetër në këtë lëmi punëson një ose dy punëtorë.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Vushtrrisë i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë: në Komizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2013-2015 të Qeverisë së Kosovës dhe prioritetet bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2013-2015 (I & II) të lëshuar nga ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është për Vushtrinë, si një qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.**

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attribute binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në tri prioritetet që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

## **Prioritetet strategjike të Qeverisë Komunale janë të përmbledhura në këto tri shtylla:**

### **1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi i standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për studime, laboratore/kabinete)
- Mbështetje direkte të sektorit bujqësor, pylltarisë e blegtorisë

### **2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/ të ardhura të ulëta

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore
- Promovimi i projekteve për rinë dhe kulturë, dhe sport

### 3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigenerimi i infrastrukturës rrugore kryesisht në qytet; transportit; ujit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi i standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara në qytet

Tri fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2013-2015 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

## III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2013-2015 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2013-2015 parashihet një rritje reale vjetore 4.9% në vitin 2013, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vendi në 2014 dhe 2015 parashihet të jetë 4.7% respektivisht 4.3%.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përket edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë. Sipas regjistrave të Komunës aktualisht ka 13,448 persona që aktivisht janë në kërkim të punës, numër ky që mund të jetë edhe më i lartë nga numri i përgjithshëm i të papunëve të cilët mund të jenë të paregjistruar ende në autoritetet përkatëse komunale.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjës së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative**. Komuna në periudhën afatmesme buxhetore 2013-2015 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal

Përshkrimi	2012 (aktual)	2013	2014	2015 (vlerësim)
<b>Indikatorët makroekonomik në Kosovë</b>				
Rritja reale e BPV në %	4.4	4.9	5.6	5.8
Inflacioni në %	1.1	1.1	2	2
BPV për kokë banori, në euro	3.4	3.9	4.7	4.3
<b>Indikatorët ekonomik komunal</b>				


Popullsia e Komunës	75.000	75.000	75.000	75.000
Numri i bizneseve të regjistruara	3,070 <sup>1</sup>	n/a	n/a	n/a
Numri i nxënësve	18.500	19.000	19.600	20.100

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2013-2015

### 3.2 Tendencat e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2013-2015

Të hyrat e Komunës së Vuçitrisë nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vite (2012 – 2015), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2013 grantet qeveritare për Komunën e Vuçitrisë si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rritja e granteve qeveritare do të jetë përafërsisht nga viti aktual 2012 deri në fund të periudhës afatmesme (2015) do të jetë përafërsisht 15% sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, sic parashihet me KASH-in 2013-2015. Rritja është reflektuar në të gjitha grantet qeveritare për Komunën e Vuçitrisë (shih më poshtë tabelën 2).

Ndërsa të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, do të shënojnë rënie të lehtë nga viti në vit. Të hyrat vetanake të planifikuara do të shënojnë rënie afërsisht 1% nga viti aktual 2012 – 2015. Kjo ulje e planifikimit në të hyrat vetanake kryesisht është bërë në buxhetet e të hyrave sic janë taksat komunale nga firmat si mënyrë e mirë për të stimuluar bizneset lokale, lejet e ndërtimit si dhe të hyrat nga gjobat në disa kategori.

<sup>1</sup> Ky është numri i bizneseve të regjistruara dhe të raportuara për vitin aktual, ndërsa vetëm 1550 prej tyre janë aktive.

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunalesipas buimit për periudhen 2013-2015, në euro

<b>PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR PERIU DHËN 2013 - 2015</b>					
N	Përshkrimi	Aktuali	Plani	Vleresimet	
R		`2012	`2013	`2014	`2015
<b>I+II</b>	<b>Te hyrat totale komunale</b>	<b>12,492,512</b>	<b>14,151,906.00</b>	<b>13,302,478</b>	<b>14,136,279</b>
<b>I</b>	<b>Grantet Qeveritare</b>	<b>10,720,512</b>	<b>12,601,906.00</b>	<b>11,652,278</b>	<b>12,375,779</b>
	Granti i Pergjithshem	3,801,910	4,113,066.00	4,450,600	4,820,300
	Granti i Arsimit	5,569,402	5,569,402.00	5,792,178	6,081,786
	Granti i Shendetesise	1,349,200	1,369,438.00	1,410,500	1,473,693
<b>II</b>	<b>Te hyrat vetanake</b>	<b>1,772,000</b>	<b>1,550,000</b>	<b>1,650,200</b>	<b>1,760,500</b>
	Tatimi në pronë	230,000	371,551	250,000	250,000
	Taksë komunale për pronësi automjeti	80,000	75,000	75,000	55,000
	Taksat komunale nga firmat	153,000	153,000	130,000	106,000
	Të hyrat nga lejet e parkingut	15,000	17,000	20,000	21,000
	Taksat nga palestra sportive	5,300	6,000	5,000	5,000
	Të hyrat nga biblioteka	1,300	1,000	1,000	1,000
	Taksa komunale për leje ndërtimi	355,400	173,600	290,000	300,000
	Taksë për regjistrimin e trashigimisë	40,000	30,000	30,000	33,000
	Taksë komunale për ndërrim pronari	30,000	12,500	20,000	22,000
	Taksa për çertifikatë të lindjes	-	-	-	-
	Taksa për çertifikatë të kurorëzimit	-	-	-	-
	Taksë për çertifikatë të vdekjes	60,000	66,000	59,000	60,000
	Taksë për verifikim të dokumenteve	-	-	-	-
	Taksa për pjesëmarrje në tender	-	-	-	-
	Gjobat nga inspeksioni	30,000	5,000	25,000	26,000
	Taksa komunale për biznese	5,000			
	Licenca për pranim teknik të lokaleve	10,000	5,000	7,000	7,000
	Shfrytëzimi i pronës publike (renta)	40,000	20,000	35,000	36,000
	Prona pub.pertreg.të hapur	-	-	-	-
	Qiraja nga objektet publike	22,000	30,000	20,000	22,000
	Participimi - shëndetësi	48,349	48,349	45,000	46,000
	Participimi në Arsim-	78,450	55,000	75,000	76,000
	Inspektimet dhe matjet në terren	111,201	72,000	100,000	102,000
	PELOJMET SANITARE	10,000	2,000	6,000	7,000
	<b>Totali i të hyrave publike</b>	<b>1,325,000</b>	<b>1,143,000</b>	<b>1,193,000</b>	<b>1,175,000</b>
	Të hyrat nga gjobat në trafik	59,000	50,000	50,000	52,000
	Të hyrat nga gjobat në gjykatë	190,000	160,000	160,000	163,000
	Të hyrat tjera /agjensioni i pjëve/	-	-	-	-
	<b>Totali i të hyrave nga gjobat</b>	<b>249,000</b>		<b>210,000</b>	<b>215,000</b>
	<b>DONACIONET E BREND SHME</b>	<b>198,000</b>	<b>197,000</b>	<b>197,000</b>	<b>260,000</b>

Komuna e Vushtrrisë vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në trivitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 85% të buxhetit total të komunës.

### 3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi i donatorëve të jashtëm në realizimin e projekteve të ndryshme për Komunën, gjatë vitit 2011 dhe 2012 është i paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 3: Të hyrat nga donatorët e jashtëm për vitin 2011-2012 ('000 Euro)

Donatori	Viti 2011	Viti 2012 (aktuale)
UNOPS – Regjistrimi i Popullsisë	5.28	
PTK – Renovimi i Shtëpisë Mehmet Agë Gjinolli	45.00	
PTK – Ndërtimi i Shtëpisë së Azem Bejtës	25	
USAID- Ndërtimi i Shëtitores, Trotualet në Lumin Sitnica	12.79	

USAID- Asfaltimi i Rrugës Pasovë-Marashan	0.00	56.14
USAID- Shpërblimi për transparencë	0.00	15.00
<b>Totali</b>	0.00	

Komuna nuk ka të planifikuar donacione të jashtme në periudhën afatmesme buxhetore 2013-2015 meqë nuk ka marrëveshje të nënshkruar me ta eventualisht dhe zotime paraprake.

### 3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Vushtrrisë në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2013-2015, sygjerimit të Qeverisë së Kosovës (përmes Ministrisë së Financave) janë që shuma e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 8%, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2014 dhe 2015 në Komizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Vushtrrisë kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të grantit të përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, komuna e Vushtrrisë do të ballafaqohet me ulje tutje të granteve qeveritare, sidomos të atyre që për kriter për ndaje marrin numrin e popullsisë, pasi që duke filluar nga viti 2013 të dhënat e regjistrimit të popullsisë gjatë vitit 2011 do të bëhen zyrtare dhe numri i banorëve të Komunës së Vushtrrisë do të dalë më i ulët se ai mbi bazën e të cilit aktualisht ndahet buxheti komunal – rrjedhimisht buxheti i komunës do të jetë më i vogël.

Së treti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grantin e arsimit, sidomos pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.

Së katërti, Komuna e Vushtrrisë ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e Komunës. Tutje, Komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë, të cilën në të ardhmen ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike.

Së pesti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Vushtrrisë, është edhe politika që do të zgjedhet nga viti 2013 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Vushtrrisë aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërime nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politika.

Së gjashti, Komuna e Vushtrrisë do të mirëpreste deklaratimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përvec pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eliminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.



Si rezultat, Tatimi në Pronë si i vetmi tatim me relevancë në Komunë ka shënuar rritje të normave si rezultat i amandamentimit të Ligjit mbi Pronën e Paluajtshme ku minimumi i normës tatimore është bërë 0.15%. Për Komunën e Vushtrrisë për vitet 2013-2015 kjo ka shënuar një rritje norme tatimore për 0.3% krahasuar me atë që është duke aplikuar në vitin 2012, ndonëse planifikimi i të hyrave nga ky burim është bërë më i ulët sesa shuma e faturimit në tabelën si vijon. Komuna ka vendosur të jetë më konzervatove në aspektin e planit të të hyrave nga tatimi në pronë duke llogaritur riskun që bartë mbi vete rritja e normave tatimore dhe mënyra si tatimpaguesit do t'i përgjigjen kësaj rritje.

Tabela 4: Shuma e tatimit në pronë e vlerësuar për 2012, me normat aktuale tatimore dhe ato të ngritura


Komuna	Numri i faturave tatimore	Shuma aktualisht e vlerësuar tatimore	Fatura mesatare aktuale	Shuma e vlerësuar tatimore me normë të ngritur në 0.15%	Fatura mesatare me normë të ngritur tatimore në 0.15%
Vushtrri	12717	343,149 €	27 €	397,195 €	31 €

Burimi: Databaza e Tatimit në Pronë për Komunën e Vushtrrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave

### 3.3 Tendanca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2013-2015

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore komunale 2012 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2013, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Vushtrrisë prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Figura 2: Shpenzimet komunale në kategori ekonomike, 2013-2015



**3.3.1 Pagat dhe Mëditjet** – Gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010, kjo kategori u ngrit me rreth 23% si rezultat i ngritjes së pagave për kategori të caktuara të shërbyesve civil por edhe i transferimit të përgjegjësive të reja. Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës 2013-2015 pritet të rritet me një mesatare vjetore prej 3.3 % bazuar në KASH-in e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rritja me e lartë prej rreth 8% në këtë kategori pritet të ndodhë gjatë vitit

2013, si rezultat i implementimit të legjislacionit sekondar që ka të bëjë me reformën në administratën publike, ndërsa për vitet vijuese kjo kategori pritet të rritet ndjeshëm. **Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt 58%.**

**3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet** - kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalitë), është rritur për 27% nga viti 2012 në vitin 2013 dhe tutje. Është një rritje e konsiderueshme e kësaj kategorie e cila kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve për mirëmbajtjen e projekteve (të reja) kapitale shkollave, punkteve shëndetësore, objekteve sportive etj) si dhe rritjes së nevojave për material shpenzues (lëndë djegëse dhe karburante në proporcion me zgjerimin sipërfaqeve të objekteve të reja). **Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë këtyre 3 vite të ardhshme pritet të jetë mesatarisht 13%.**

**3.3.3 Subvencionet** – kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës së projektuar, pritet të shënoj ngritje për 41% krahasuar e vitin 2012 si rezultat i zgjerimit të skemave të përfituesve kryesisht në fushën e bujqësisë. Rritja me e theksuar është në vitin 2013 ndërsa në dy vitet tjera të projeksionuara nuk do të ketë lëvizje të buxhetit të ndarë për këtë kategori. Ndonëse kjo rritje nga viti 2012 në 2013 i atribuohet kryesisht subvencioneve që do të ofrohen për bujqësinë, një pjesë të këtij buxheti të rritur planifikohet të shpërndahet edhe në shëndetësi për shpërndarjen e ilaqeve shtesë nga lista esenciale që shpërndanë MeSH si dhe ndihmë për shërimë jashtë vendit bazuar në kërkesat e deponuara. Një fushë tjetër të cilës i atribuohet rritja e kësaj kategorie buxhetore në vitin 2013 janë edhe klubet sportive dhe ato për zhvillimin e kulturës në komunë. **Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2013-2015 mesatarisht dotë jetë 1.2%.**

Tabela 5: Përbajtja e shpërndarjes së subvencioneve në periudhën afatmesme

2012		2013		2014		2015	
<b>Bujqësi dhe Blegtori</b>							
Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit
<b>Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale</b>							
Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit
<b>Arsim</b>							
Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit
<b>Kulturë, Rini, Sport</b>							
Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit	Emri i Projektit	Shuma e Subvencionit

**3.3.4 Investimet Kapitale** - kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rënie sidomos në vitin 2013, për 7.6% krahasuar me vitin 2012 si rezultat i shpërndarjes më të madhe buxhetore në kategoritë e tjera ekonomike dhe rritjes

së dedikuar në subvencione dhe mallra dhe shërbime. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rënia në investimet kapitale, nga buxheti i komunës do të përmirësohet nga viti në vit, mirëpo edhe në vitin 2015 do të vazhdojë të jetë më e ulët nga aktualja (2012) **Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2013 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: 27.8%.**

Tabela 6: Korniza Buxhetore Komunale, në euro

	Përshkrimi	2012 (buxheti aktual)	2013 (plani)	2014 (vlerësimet)	2015 (vlerësimet)
<b>1.</b>	<b>TE HYRAT TOTALE KOMUNALE</b>	12,492,512	14,151,906	13,302,478	14,136,279
1.1	Të hyrat vetanake	1,772,000	1,550,000	1,650,200	1,760,500
1.2	Grantet dhe transferet qeveritare	10,720,512	12,601,906	11,652,278	12,375,779
<b>2.</b>	<b>SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE</b>	12,492,512	14,151,906	13,302,478	14,136,279
2.1	Shpenzimet mjedhëse	0.00	0.00	0.00	0.00
	Pagat dhe mëditjet	7,222,060	7,296,849	7,387,785.14	7,387,785.14
	Mallrat dhe shërbimet	1,337,494	1,700,000	1,700,000	1,700,000
	Subvencionet	109,862	155,000	155,000	155,000
2.2	Shpenzimet Kapitale	3,823,095	3,529,846	3,529,846	3,529,846
	Nga të cilat: Grantet e jashtme për projekte kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>3.</b>	<b>BILANCI PRIMAR BUXHETOR</b>	0.00	0.00	0.00	0.00
3.1	Pagesa e interesit për borxhin e jashtëm	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>4.</b>	<b>BILANCI TOTAL BUXHETOR</b>	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>5.</b>	<b>FINANCIMI</b>	0.00	0.00	0.00	0.00
5.1	Financimi i jashtëm	0.00	0.00	0.00	0.00
	Ripagimi i borxhit kryesor	0.00	0.00	0.00	0.00
	Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00
5.2	Financimi i brendshëm	0.00	0.00	0.00	0.00
	Shitja e aseteve	0.00	0.00	0.00	0.00
	Huamarrja e brendshme	0.00	0.00	0.00	0.00
	Ndryshimi në fitimet e pashpërndara	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>6.</b>	<b>BILANCI BANKAR NË FUND TË VITIT</b>	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktualet të vitit 2012, planifikimi për vitin e ardhshëm 2013 si dhe projeksionet e vitit 2014-2015. Vëreni se ndryshimet më të mëdha buxhetore janë të reflektuara në kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime si dhe subvencione, dhe atë kryesisht në vitin 2013 si rezultat i fleksibilitetit të lejuar nga Ministria e Financave në shpërndarjen e të hyrave vetanake të komunës, në të gjitha kategoritë ekonomike (përveq pagave dhe mëditjeve) të lejuar duke filluar nga viti 2013. Ndërkaq që kjo rritje bëhet më pak e vërejtshme në projeksionet 2014-2015. Nevoja për këtë rritje në këto kategori ka qenë e kahershme ndërkohë që limitet buxhetore të vendosura nga Ministria e Financave nuk kanë lejuar që kjo tëndodhë deri tash.

Tabela 7: Shpenzimet Komunale 2012, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Programet	2012					
	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej

Zyra e Kryetari	94,348	30,000	-	-	-	167,266
Zyra e Kuvendit komunal	170,820	4,000	-	-	-	174,820
Administrata dhe Personeli	136,832	86,606	-	-	32,000	255,438
Inspektimet	69,546	10,000	-	-	4,000	83,546
Prokurimi	20,056	10,000	-	--	-	30,056
Buxhet dhe financa	121,725	10,000	-	-	-	131,725
Infrastruktur Publike	235,780	200,000	144,500	-	1,004,256	1,584,536
Zjarfiksit dhe Inspektimet	69,546	10,000	-	-	4,000	83,546
Zyra Komonale per Komunitet	31,529	4,000	2,500	-	-	38,029
Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural	62,898	10,000	3,000	-	85,000	160,898
Zhvillim Ekonomik	-	-	-	-	-	-
Kadastra dhe Gjeodezia	42,882	5,000	-	-	80,000	127,882
Planifikimi Urban dhe Mjedis	44,342	5,000	-	-	2,345,000	2,394,342
<b>Shëndetësi</b>	<b>1,107,903</b>	<b>185,217</b>	<b>32,500</b>	<b>66,944</b>	<b>54,985</b>	<b>1,447,549</b>
Kulturë, Rini dhe Sport	139,672	20,000	-	-	35,000	194,672
<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>4,943,727</b>	<b>482,921</b>	<b>92,250</b>	<b>-</b>	<b>182,854</b>	<b>5,701,752</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>7,222,060.00</b>	<b>1,062,744.00</b>	<b>274,750.00</b>	<b>109,862.00</b>	<b>3,823,095.00</b>	<b>12,492,512.00</b>

Tabela 8: Shpenzimet Komonale për 2013, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Programet	2013					Gjithsejt
	Paga & Meditje	Mallra & Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	
Zyra e Kryetarit	112,079.39	59,600.00	-	-	-	171,679.39
Zyra e Kuvendit Komunal	168,568.65	5,000.00	-	-	-	173,568.65
Administrata	126,364.77	109,070.00	-	-	65,000.00	300,434.77
Inspektimet	70,357.01	26,000.00	-	-	-	96,357.01
Prokurimi	21,600.00	10,000.00	-	-	-	31,600.00
Buxheti & financat	122,297.62	13,000.00	-	-	-	135,297.62
Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjence	235,471.57	295,170.00	162,500.00	-	1,110,000.00	1,803,141.57
Zyra e komuniteteve	30,951.52	4,000.00	2,500.00	-	-	37,451.52
Bujqësia, Pyltari dhe hidroekonomi	62,897.94	12,200.00	-	7,000.00	72,000.00	154,097.94
Kadastra dhe gjeodezia	43,547.24	10,000.00	-	-	100,000.00	153,547.24
Planifikim Urbanizm	39,837.17	18,500.00	-	-	2,050,000.00	2,108,337.17
Kultura, rinia & sportet	136,457.12	26,700.00	-	47,000.00	132,846.00	343,003.12
<b>Totali i Administrates</b>						-
<b>Arsim dhe Shkence</b>						-
administrata	39,637.00	595,543.00	11,550.00	25,000.00		671,730.00
arsimi parafillor	123,316.00		11,600.00			134,916.00
arsimi fillor	3,774,416.00		60,250.00			3,909,455.00

arsimi I mesem	1,006,358.00		19,100.00		1,025,458.00
<b>Shëndetsia</b>					-
Kujdesi primar shëndesor	1,019,982.00	215,217.00	32,500.00		1,267,699.00
Administrata	39,078.00	-	-	76,000.00	115,078.00
shërbimet sociale	48,843.00	-	-	-	48,843.00
	-	-	-	-	-
<b>Gjithsejt</b>	<b>7,222,060.00</b>	<b>1,400,000.00</b>	<b>300,000.00</b>	<b>155,000.00</b>	<b>3,529,846.00</b>

Tabla 9: Shpenzimet Komunale, projeksionet 2014-2015, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Programet	2014						2015					
	Paga/Meditje	Mallra/Sheherbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapital e	Gjithsej	Paga/Meditje	Mallra/Sheherbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapital e	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	112,079.39	59,600	-	-	-	171,679	112,079.39	59,600	-	-	-	171,679
Zyra e Kuvendit komunal	168,568.65	5,000	-	-	-	173,568.65	168,568.65	5,000	-	-	-	173,568.65
Administrata dhe Personeli	126,364.77	109,070	-	-	65,000	300,434.77	126,364.77	109,070	-	-	65,000	300,434.77
Inspektimet	70,357.01	26,000	-	-	-	96,357.01	70,357.01	26,000	-	-	-	96,357.01
Prokurimi	21,600	10,000	-	-	-	31,600	21,600	10,000	-	-	-	31,600
Buxheti dhe financa	122,297	13,000	-	-	-	135,297.62	122,297	13,000	-	-	-	135,297.62
Infrastruktur Publike	235,471.57	295,170	162,500	-	1,110,000	1,803,141.57	235,471.57	295,170	162,500	-	1,110,000	1,803,141.57
Zyra Komurale per Komunitet	30,951.52	4000	2,500	-	-	37,451.52	30,951.52	4000	2,500	-	-	37,451.52
Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	62,897.94	12,200	-	7,000	72,000	154,097.94	62,897.94	12,200	-	7,000	72,000	154,097.94
Zhvillim Ekonomik												
Kadastra dhe Gjeodezia	43,547.24	10,000	-	-	100,000	153,547.24	30,951.52	4000	2,500	-	-	37,451.52
Planifikimi Urban dhe Mjedis	39,837.17	18,500	-	-	2,580,846.94	2,108,337.17	62,897.94	12,200	-	7,000	72,000	154,097.94
<b>Shëndetësi</b>	1,107,903	215,217	32,500	76,000	-	1,418,488	30,951.52	4000	2,500	-	-	37,451.52
Kulturë, Rini dhe Sport	136,457.12	26,700	-	47,000	132,846	343,003.12	62,897.94	12,200	-	7,000	72,000	154,097.94
Arsim dhe shkencë	5,018,516	595,543	102,500	25,000	-	5,741,559	30,951.52	4000	2,500	-	-	37,451.52
<b>GJITHSEJ</b>	<b>7,387,785.14</b>	<b>1,400,000.00</b>	<b>300,000.00</b>	<b>155,000.00</b>	<b>4,060,692.94</b>	<b>13,303,478.08</b>	<b>7,387,785.14</b>	<b>1,400,000.00</b>	<b>300,000.00</b>	<b>155,000.00</b>	<b>3,529,846.00</b>	<b>14,136,279.90</b>

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapital e - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit, për Komunën e Vushtrrisë. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Vushtrrisë

në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë. Tabela 10: Projektet Kapitalë të komunës 2013-2015, dhe kostoja e asocuar me tonë Euro

<b>LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2013</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Programi</b>	<b>Emri I projekteve</b>	<b>Shuma</b>
1.	Administrata	Kamerat në qytet	10,000.00
		Paisje me teknologji informative	5,000.00
		Inventari i komunës – objekt i ri	50,000.00
	<b>Total</b>		<b>65,000.00</b>
2	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	Hapësira te objekti i komunes	150,000.00
		Rregullimi i shtratit te lumit	130,000.00
		Riasfaltimet e rrugëve	40,000.00
		Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara	30,000.00
		Mirëmbajtja e rrugëve te rendit te IV	10,000.00
		Fondi per bashkëfinancim me trotuar dhe kubëza betoni	200,000.00
		Fondi per bashkëfinancim për rrugë kubëza dhe donacione	100,000.00
		Gjelbërim dhe mirëmbajtje	40,000.00
		Ndriçimi publik	30,000.00
		Sinjalizimi horizontal	30,000.00
		Rrjeti i ujsjellsit	200,000.00
		Kanalizime	100,000.00
		Furnizim me gypa	50,000.00
	<b>Total</b>		<b>1,110,000.00</b>
3	Bujqësia	Hartimi i strategjisë zhvillimore	20,000.00
		Ngritja e serave	30,000.00
		Projekte për bujqësi -eko me bashkëf.	20,000.00
		Motoçikleta për pylltar	2,000.00
			<b>72,000.00</b>
4	Planifikimi urban dhe inspeksioni	Asfaltimi i rr.Deshmoret e kombit	850,000.00
		Asfaltim rr. Ismail Qemali	60,000.00
		Hartimi i projekteve	55,000.00
		Asfaltim i rr.lokale Bivok	50,000.00
		Asfaltim i rr. lokale te Nemozht	60,000.00
		Asfaltim I rr.lokale Bukosh, Lagjja Zeka	60,000.00
		Asfaltim I rr.lokale Kollë- Bruznicë	40,000.00
		Asfaltim I rr.lokale Gllavatinë si dhe kanalizimi	35,000.00
		Asfaltim I rr.lokale Lagjja Kovaqi	30,000.00
		Asfaltim I rr.Lokale Novolan -Lagjja Zhabari	20,000.00
		Asfaltim I rr. Lagjja Morina	50,000.00

		Asfalum I rr.Pantinë, Lagja Imeti,Sejdiu	60,000.00
		Asfalum I rr. Pirqi	30,000.00
		Asfalum I rr.Tri Dumnicat	80,000.00
		Asfalum I rr.Smrekovnice	25,000.00
		Asfalum I rr.Smrekovnice (nen burg)	40,000.00
		Asfalum I rr.Slatinë	40,000.00
		Asfalum I rr.Terllabuq	35,000.00
		Asfalum I rr.Gumnishtë	50,000.00
		Asfalum I rr.Maxhunaj, lagja Memnica	45,000.00
		Asfalum I rr.Sfaraqaku	60,000.00
		Asfalum I rr.Studime e Epërme	30,000.00
		Asfalum I rr.Samadregj, Lagja Bunjaku dhe Musa	45,000.00
		Asfalum I rr.Stanovc	150,000.00
		Asfalum I rr.Prelluzhë, Lagja Duraku	30,000.00
		Hartimi i planeve rregulluse urbane	20,000.00
	<b>TOTAL</b>		<b>2,050,000.00</b>
<b>5</b>	Kadaster dhe Gjeodozi	Shpronësimi	100,000.00
	<b>TOTAL</b>		<b>100,000.00</b>
<b>6</b>	<b>KULTURE RINI DHE SPORT</b>	Restaurimi i shpisë së kultures	50,000.00
		Restaurimi i muzeut	82,846.00
	<b>Total</b>		<b>132,846.00</b>
		<b>TOTALI</b>	<b>3,529,846.00</b>

**LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2014**

<b>Nr.</b>	<b>Programi</b>	<b>Emri I projekteve</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Administrata	Kamerat ne qytet	10,000.00
		Pajisje me teknologji informative	5,000.00
	<b>Total</b>		<b>15,000.00</b>
<b>2</b>	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	Ri-asfaltimet e rrugëve	50,000.00
		Mirëmbajtja e rrugëve te asfaltuara	30,000.00
		Mirëmbajtja e rrugëve te rendit te IV	50,000.00
		Fondi per bashkëfinancim per rrugë kubza dhe donacione	100,000.00
		Gjelbërim dhe mirëmbajtje	30,000.00
		Ndriçimi publik	30,000.00
		Sinjalizimi horizontal	40,000.00
		Rrjeti i ujës jellshit	200,000.00
		Kanalizime	100,000.00
		Furnizim me gypa	100,000.00
		Ndërtimi i objekteve për banim famil.deshm.inv dhe familjeve pa shtëpi	400,000.00
		Ndërtimi i rrugëve lokale neper fshatra	700,000.00

		Ndertimi i kanalizimeve neper fshatra	150,000.00
		Ndertimi i kolektorit kryesor te Komunes-pergjate lumit Sitnica	200,000.00
		Riparimi i rrjetit te ujesjellsit ne qytet	25,000.00
	<b>Total</b>		<b>2,205,000.00</b>
<b>3</b>	Bujqesia	Projekt per bujqesi -eko.me bashkf.	100,000.00
	<b>Total</b>		<b>100,000.00</b>
<b>4</b>	Planifikimi urban dhe inspeksioni	Asfaltimi i rr.Deshmoret e kombit	100,000.00
		Asfaltim rr.Eestly Clark dhe Adem Jashari	300,000.00
		Hartimi i planeve rregulluese urbane	50,000.00
	<b>Total</b>		<b>450,000.00</b>
<b>5</b>	Kadaster dhe Gjeodozi	Shpronsimi	100,000.00
	<b>Total</b>		<b>100,000.00</b>
<b>6</b>	Granti i Shendetesisë	Ndertimi i ambulancave ne ASH	50,000.00
		Blerja e autobolancave	60,000.00
	<b>Total</b>		<b>110,000.00</b>
<b>7</b>	<b>KULTURË RINI DHE SPORT</b>	Restaurimi I muzeut	100,000.00
		Ndertimi I sheshit Hasan Prishtina	150,000.00
		Ndertimi I fushave sportive neper fshatra	100,000.00
		Restaurimi I objekteve me trashigimi kulturore	100,000.00
		Qendra kulturore	150,000.00
	<b>Total</b>		<b>600,000.00</b>
<b>8</b>	Granti i Arsimit	Shkolla fillore te Podranqja	150,000.00
		Ndertimi i shkollave neper fshatra	200,000.00
	<b>Total</b>		<b>350,000.00</b>
		<b>TOTALI</b>	<b>3,950,000.00</b>
<b>LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2015</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Programi</b>	<b>Emri I projekteve</b>	
<b>1</b>	Administrata	Kamerat ne qytet	10,000.00
		Paisje me teknologji informative	5,000.00
	<b>Total</b>		<b>20,000.00</b>
<b>2</b>	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	Ri-asfaltimet e rrugëve	50,000.00
		Mirëmbajtja e rrugëve te asfaltuara	30,000.00
		Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të IV	20,000.00
		Fondi për bashkëfinancim me trotuar dhe kubëza betoni	150,000.00
		Fondi per bashkëfinancim per rrugë kubëza	100,000.00
		Gjelbërim dhe mirëmbajtje	30,000.00
		Ndriçimi publik	30,000.00
		Sinjalizimi horizontal	40,000.00
		Rrjeti i ujesjellsit	200,000.00
		Kanalizime	100,000.00
		Furnizim me gypa	100,000.00



		Ndërtimi i objekteve për banim famil.deshm.inv dhe familjeve pa shtëh	400,000.00
		Ndërtimi i rrugëve lokale neper fshatra	700,000.00
		Ndërtimi i kanalizimeve neper fshatra	150,000
		Ndërtimi i kolektorit kryesor te Komunes-pergjatë lumit Sitnica	200,000
<b>3</b>	<b>Total</b>		<b>2,300,000.00</b>
	Bujqësia	Subvencionimi i bujqve	100,000.00
	<b>Total</b>		<b>100,000.00</b>
	Planifikimi urban dhe inspeksioni	Hartimi i planeve rregulluese urbane	50,000.00
	<b>Total</b>		<b>50,000.00</b>
<b>4</b>	Kadaster dhe Gjeodezi	Shpronësimi	100,000.00
	<b>Total</b>		<b>100,000.00</b>
<b>5</b>	Granti i Shëndetësisë	Ndërtimi i QKMF-se	400,000
		Ndërtimi i ambulancave ne ASH	50,000
		Blerja e autoambulancave	50,000
	<b>Total</b>		<b>5,00,000.00</b>
<b>6</b>	<b>KULTURË RINI DHE SPORT</b>	Ndërtimi i fushave sportive nëpër fshatra	100,000.00
		Restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore	100,000.00
	<b>Total</b>		<b>200,000.00</b>
<b>7</b>	Granti i Arsimit	Shkola fillore te podranja	100,000.00
		Ndërtimi i shkollave neper fshatra	200,000.00
	<b>TOTAL</b>		<b>300,000.00</b>
	<b>TOTALI</b>		<b>4,164,279.00</b>